




BASHKIA KAMEZ
DREJTORIA E P.K.Zh.T-se



Procurement
Albania

Punuan:

Ing. Flora MUCA
Ing. Nderim PASHA
Ing. Elmaz MURATI
Ing. Ramadan HYSA

Drejtori i P.K.Zh.T-se
Ark. A. TOLA

MZIU

MIRATOI
Xhelal

K R Y E T A R

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1- Hyrje
- 1.2- Pozicioni i objektit
- 1.3- Gjendja Ekzistuese
- 1.4- Kushtet Klimatike te Zones
- 1.5- Rilevimi Topografik
- 1.6- Studimi Gjeologjik

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

- 2.1- Projekti i rruges

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

- 1. Preventivi i punimeve te ndertimit te rruges.

1. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT

1) TE PERGJITHSHME

1.1-Hyrje

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion do te realizoje projektin e zbatimit per objektet :

Ndertim Rr. “Mamurras”, Rr. ”Perjetesia”, Rr.“Fierze” Rr.”Jena”, Rr.”Kongresi i Manastirit” Seg. Rr. “Kujtesa” dhe Rr. ”Amsterdam+ Hyqmete Dervishi” Lagjia 3 Kamez dhe Lagje Valias.

1.2-Pozicioni i objektit

Keto segmente rrugore sherben per te lidhur rruget e lagjes nr.3 Kamez dhe rruget ne lagjen Valias dhe Valias i Ri.

Rruga “Mamurras” ku do te investohet ka gjatesi L= 496 ml.

Ne kete segment rruge gjeresia ekzistuese eshte 7-9 m.

Rruga “Perjetesia” ku do te investohet ka gjatesi L= 595 ml.

Ne kete segment rruge gjeresia ekzistuese eshte 7.5- 9 m.

Rruga “Fierze” ku do te investohet ka gjatesi L=290 ml.

Ne kete segment rruge gjeresia ekzistuese eshte 3-5 m.

Rruga “Jena” ku do te investohet ka gjatesi L= 150 ml.

Ne kete segment rruge gjeresia ekzistuese eshte 5 m.

Rruga “Kongresi i Manastirit” ku do te investohet ka gjatesi L= 480 ml.

Ne kete segment rruge gjeresia ekzistuese eshte 8 m.

Seg. Rruga “Kujtesa” ku do te investohet ka gjatesi L= 180 ml.

Ne kete segment rruge gjeresia ekzistuese eshte 7-9 m.

Rruga “Amsterdam” + “Hyqmete dervishi” ku do te investohet ka gjatesi L= 540 ml.

Ne kete segment nuk ka rruge ekzistuese eshte kanali me gjersi 3-5m.

1.3-Gjendja ekzistuese

Gjendja aktuale e objektit paraqitet:

Trupi i rrugeve:

Keto segmente rruge jane te pashtuar, dhe ndodhet ne brendesi te lagjes nr.3 Kamez dhe lagjen Valias. Ne keto segmente rrugor jane bere me pare investime si tek rruga Kongresi i Manastirit ka KUN bordura dhe kunete do te behet vetem riparimi i asfaltit. Gjate gjithë gjatesise se ketyre rrugve ka mure rrethues te shtepive qe ndodhen ne te dy anet e rruges.

Sistemi i K.U.N: Kjo zone ka rrjet **K.U.N**-je vetem tek rruga Amsterdam + Hyqmete Dervishi nuk ka dhe eshte parashikuar te behet rrjeti i KUN-se.

Sistemi i UJESJELLESIT: Ne kete zone pjeserisht jane vendosur linja kryesore te furnizimit me uje te shtepive te banimit.

1.4-Kushtet Klimatike Te Zones

Zona dallohet per dimer te bute me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme . Si gjithë zona mesdhetare, ne pergjithesi ka nje sasi te konsiderueshme kohe me diell. Kjo arrin ne 2560 ore ne vit, me maksimum ne muajin Korrik me 360 ore dhe minimum 100 ore ne Dhjetor . Presioni atmosferik sipas te dhenave shume vjeçare leviz nga 752-753 milimetra, e barabarte kjo me 1002.6-100.9 milibar.

Vlerat e temperatures se ajrit ne pergjithesi jane te qendrueshme .

Periudha me temperatura mesatare $> 7^{\circ}\text{C}$ zgjat afersisht 10 muaj.

Kjo zone perfshihet ne zonen klimaterike mesdhetare fushore qendrore. Temperatura mesatare vjetore leviz ne $15-16^{\circ}\text{C}$. Temperatura maksimale eshte regjistruar ne date 13.07.1973 me 43°C , ndersa temperatura minimale eshte regjistruar ne date 15.01.1968 me -14.4°C .

Amplituda e ndryshimeve midis dites dhe nates eshte e ndjeshme dhe leviz nga 6 deri ne $12-14^{\circ}\text{C}$.

Lageshtia mesatare relative e ajrit arrin ne rreth 70 %.

Sipas te dhenave shumvjeçare statistikore te sherbimit hidrometeorologjike,

sasia mesatare vjetore e shiut arrin ne 1247 mm numri i diteve me reshje eshte > 10 mm leviz mesatarisht nga 85 ne 100 dite.

Era fryn pergjithesisht ne dy drejtime. Gjate gjysmes se ftohte te vitit mbizoteron juglindja pa perjashtuar veriun, ne gjysmen e ngrohte te vitit mbizoteron veriperendimi.

1.5-Rilevimi Topografik

Per hartimin e Relievit te zones gjate muajit Nentor jane kryer matjet topografike ne terren. Ne baze te ketyre matjeve eshte hartuar planimetria e gjendjes ekzistuese ne shkallen 1:500 dhe profilet gjatesore, qe do te jene baze per zgjidhjen e projektit.

1.6-Studimi Gjeologjik

Nga ana e ndertimit gjeologjik, rajoni i Tiranes ben pjese ne strukturen e sinklinalit te Tiranes, e cila ndertohet kryesisht nga formacione e moshes se Neogenit (N 2) - Keto formacione ndertojne vargjet kodrinore qe qarkojne qytetin dhe perfaqeson nga pako ranore, alevrolite dhe argjila alevrolitike. Gjithashtu keto formacione sherbejne si bazament i depozitimit me te reja kuaternare (Qu). Depozitimet kuaternare ndertojne gjithte pjesen fushore ku eshte ndertuar qyteti i Kamzes dhe pjesa tjeter e zones ne studim. Keto depozitime perfaqesohen nga dhera suargjilore, suranore, si dhe depozitime aluvionale zhavorore te lumenjve te Tiranes, te Lanes dhe te teracave te tyre, trashesia e pergjitheshme e te cilave arrin 3-4 m ekstremet e fushes deri ne rreth 20m ne pjeset e tjera te qytetit.

Zona qe trajtohet ne kete projekt, ben pjese ne zonen e perhapjes se depozitimeve te terraces se dyte te lumit te Tiranes, e cila ze pjesen me te madhe dhe kryesore te teritorit te qytetit.

Depozitimet e kesaj tarace ku ben pjese dhe zona ne studim, karakterizohen nga prania e dherave deluviale te perbera nga suargjila me ngjyre te kuqerremte dhe kafe te hapur, si dhe nga prania e depozitimeve zhavorore.

Keshtu ne zonen tone, ne pjesen me te siperme kemi te bejme me suargjila ngjyre kafe te kuqerremet, te pluhuruara, me lageshti, ne gjendje plastike dhe mesatarisht te ngjeshura . Trashesia e kesaj shtrese leviz 1,5- 3,5 m dhe karakterizohet nga keto tregues fiziko – mekanike mesatare:

- Pesha volumore ne gjendje natyrale $\Delta = 1.25 - 1.76 \text{ g/cm}^3$

- Pesha volumore te skeletit $\delta = 1.18 - 1.4 \text{ g/cm}^3$
- Koefiçienti i porozitetit $\varepsilon = 0.85 - 1.2$
- Kendi i ferkimit te brendshem $\varphi = 17^\circ - 22^\circ$
- Kohezioni $c = 0.25 - 0.50 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar ne shtypje $\bar{\sigma} = 1.2 - 1.7 \text{ kg/cm}^2$

Nen keto depozitime pergjithesisht takohen shtresa suargjilash te lehta dhe te mesme te pluhuruara , me ngjyre kafe te hapura ne gjendje plastike dhe mesatarisht te ngjeshura dhe kane trashesi qe arrin 2-4 m .

Keto depozitime ne ekstremin perendimor te zones dalin ne siperfaqe ketu fillon ndikimi i depozitimeve te terraces se lumit Tirane dhe shtresa e suargjilave te kuqeremta gradualisht reduktohet.

Keto depozitime karakterizohen nga keto tregues fiziko-mekanike:

- Pesha volumore ne gjendje natyrale $\Delta = 1.82 - 2.0 \text{ g/cm}^3$
- Pesha volumore te skeletit $\delta = 1.48 - 1.64 \text{ g/cm}^3$
- Koefiçienti i porozitetit $\varepsilon = 0.65 - 0.82$
- Kendi i ferkimit te brendshem $\varphi = 19^\circ - 24^\circ$
- Kohezioni $c = 0.20 - 0.45 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar ne shtypje $\bar{\sigma} = 1.8 - 2.2 \text{ kg/cm}^2$

Pergjithesisht, nen depozitimet e pershkruara me siper, takohen depozitimet zhavorore, me perberje kryesisht ranore dhe gelqerore me madhesi nga 1-2cm deri 8-10cm, me rrumbullakosje mesatare dhe me mbushes materiali suranor dhe suargjilor te lehte; te cilat karakterizohen nga tregues te mire fiziko-mekanike.

Trashesia e ketyre depozitimeve leviz nga 1-3m dhe pergjithesisht paraqiten ujembajtes. Se fundi, nen depozitimet kuaternare te larte permendura, ne taban te tyre kemi te bejme me formacionet renjesore te cilat perbehen kryesisht nga argjila alevrolite ngjyre gri kalter ne gjendje kompakte, dhe ne disa raste nga ranore kokerr imet me çimentim te dobet me ngjyre gri e te verdhe.

1. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

1.1- Projekti i asfaltimit te rrugve

Segmentet i Rr. “Mamurras”, Rr.”Perjetesia” ,
Rr.”Fierze”,Rr.”Jena”, Rr.”Kong. i Manastirit”, Seg.i Rr.”Kujtesa” dhe
Rr.”Amsterdam +Hyqmete Dervishi”. ne lagjen nr.3 Kamez dhe Lagjen
Valias.

1. Segmenti i Rr. “Mamurras” lagje Valias :

Segmenti rrugor do te ketë keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 496$ ml.
- Gjeresi e rruges $B = 9$ ml
- Gjeresi asfaltit $b = 5$ m, (2×2) m bankine

2. Segmenti i rruges “Perjetesia” ne lagjen Valias :

Segmenti rrugor do te ketë keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 595$ ml.
- Gjeresi e rruges $B = 9$ ml
- Gjeresi asfaltit $b = 5$ m, (2×2) m bankine

3. Segmenti i rruges “Fierze” ne lagjen nr.3 Kamez:

Segmenti rrugor do te ketë keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 290$ ml.
- Gjeresi e rruges $B = 5$ ml
- Gjeresi asfaltit $b = 4$ m, (0.5×2) m bankine

4. Segmenti i rruges “Jena” ne lagjen nr.3 Kamez:

Segmenti rrugor do te kete keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 150$ ml.
- Gjeresi e rruges $B = 5$ ml
- Gjeresi asfaltit $b = 4$ m, (0.5×2) m bankine

5. Segmenti i rruges “Kongresi i Manastirit” ne lagjen nr.3 Kamez:

Segmenti rrugor do te kete keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 480$ ml.
- Gjeresi asfaltit $b = 4$ m

6. Segmenti i rruges “Kujtesa” ne lagjen Valias:

Segmenti rrugor do te kete keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 180$ ml.
- Gjeresi e rruges $B = 9$ ml
- Gjeresi asfaltit $b = 5$ m, (2×2) m bankine

7. Segmenti i rruges “Amsterdam” + “Hyqmete Dervishi” ne lagjen nr.3 Kamez:

Segmenti rrugor do te kete keto parametra:

- Gjatesi e rruges $L = 540$ ml.
- Gjeresi e rruges $B = 4$ ml
- Gjeresi asfaltit $b = 4$ m, (0.5×2) m bankine

- Ne zgjidhjen e projektit jane pasur parasysh:

- a) Zgjidhja ne anen Planimetrike te rruges.
- b) Zgjidhja ne anen altimetrike te rruges.
- c) Elementet sociale te rruges.

1. Zgjidhja Planimetrike

Ne zgjidhjen planimetrike eshte pasur parasysh ndertimi i ketyre rrugeve te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese.

Ne hyrjet e banesave do te behet rakordimi i tille qe lejon hyrjen normale te mjeteve.

2. Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik ne drejtimin gjatesor ka nje pjerresi te lehte ne renie drejt lindje - perndim. Keto objekte do te ndertohen mbi rruge ekzistuese e cila ka nivelete te crrregullt, do te synohet ne krijimin e nj nivelete me pjerresi te lehte e uniforme.

3. Profili Gjatesor.

Profili gjatesor perfaqeson prerjen e rruges sipas aksit te saj ne drejtimin vertikal. Profili gjatesor eshte hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe ne shkalle horizontale 1:1000.

Ne te jane paraqitur:

- Vija e Terrenit
- Vija e Projektit
- Disnivelet e Vijes se Projektit
- Numri i Piketes (Seksionit)
- Kuota e Terrenit
- Kuota e Projektit
- Distanca Pjesore
- Distanca Progressive

4. Profilat Terthore.

Profilat terthore perfaqesojne prerje te rruges terthor me aksin e saj ne drejtimin vertikal.

Profilat terthore jane hartuar ne shkalle vertikale dhe horizontale 1:100.

Ne profilat terthore jane paraqitur:

- Numri i profilit
- Distanca progresive
- Vija e terrenit
- Vija e projektit
- Disnivelet e vijes se projektit
- Numri i piketes
- Kuotat e terrenit
- Kuotat e projektit
- Distanca pjesore nga aksi
- Distanca e pergjithshme nga aksi

5. *Profilat Terthore.*

Ne profilat tip jane paraqitur ne menyre te detajuar:

- Shtresat rrugore
- Dimensionet e tyre
- Vendosja e tyre
- Distanca
- Zona ku aplikohet profili tip

6. *Zgjidhja sociale.*

Duke pasur parasysh qe kjo zone eshte ne zhvillim e siper eshte pasur parasysh qe kjo rruge te behet me parametra qe t'i pershtaten zhvillimit te zones dhe hyrje daljet nga shtepite te kene lirshmeri.

7. Llogaritja e shtresave te rruges.

Nga studimi i gjendjes ekzistuese del qe asfaltimi do te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese.

8. Shtresat e rruges.

Per te gjithë segmentin rrugor shtresat e dala nga llogaritja do te jene:

- Asfaltobeton 4 cm
- Binder 5 cm
- Stabilizant 10 cm
- Çakull 10 cm



2. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT

PROJEKT – ZBATIM PERMBAN KETO KAPITUJ:

1. KAPAKU I PROJEKTIT
2. IMAZHI AJROR
3. PLANIMETRIA EKZISTUESE
4. PLANIMETRIA E PRISHJEVE
5. PLANIMETRIA E ASFALTIT
6. PROFILI TERTHORE TIP

